

**SHOQËRIA "CHERY ALBANIA" sh.p.k**  
**NIPT L81317008S**  
**SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE**  
**(PER USHTRIMIN E MBYLLUR ME DATEN 31 DHJETOR 2018)**

Sqarim

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2. Plotësimi I të dhënave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte të përcaktuara në SKK 2 dhe konkretisht paragrafeve 49-55.

Radha e dhënies së spjegimeve duhet të jetë:

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël
- b) Shënimet që shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare.
- c) Shënime të tjera shpjeguese.

**A I Informacion i përgjithshëm**

- |   |   |
|---|---|
| 1 | Kuadri ligjor: Ligji 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"     |
| 2 | Kuadri kontabël i aplikuar : Standartet Kombëtare te Kontabilitetit ne Shqipëri.(SKK 2; 49) |
| 3 | Baza e përgatitjes së PF : Të drejtat dhe detyrimet e konstatuara.(SSK 1, 35)               |
| 4 | Parimet dhe karakteristikat cilësore të përdorura për hartimin e P.F. : (SSK 1; 37 - 69)    |

**a) NJËSIA EKONOMIKE RAPORTUESE** ka mbajtur në llogaritë e saj aktivet, pasivet dhe transaksionet ekonomike të veta.

**b) VIJMËSIA** e veprimtarisë ekonomike te njësisë sonë raportuese është e siguruar duke mos pasur në plan ose nevojë ndërprerjen e aktivitetit të saj.

**c) KOMPENSIM** midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka, ndërsa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetëm në rastet që lejohen nga SKK.

**d) KUPTUESHMERIA** e Pasqyrave Financiare është realizuar ne masën e plotë për te qënë të qarta dhe të kuptueshme për përdorues të jashtëm që kanë njohuri të përgjithshme të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit.

**e) MATERIALITETI** është vlerësuar nga ana jonë dhe në bazë të tij Pasqyrat Financiare janë hartuar vetëm për zëra materiale.

**f) BESUESHMERIA** për hartimin e Pasqyrave Financiare është e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e mëposhtme:



Parimin e paraqitjes me besnikëri

Parimin e perparësise së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore

Parimin e paanshmërisë pa asnjë influencim të qëllimshëm.

Parimin e maturisë pa optimizëm të tepruar, pa nën/mbivlerësim të qëllimshëm

Parimin e plotësisë duke paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të PF

Parimin e qëndrueshmërisë për të mos ndryshuar politikën e metodat kontabël

Parimin e krahasueshmërisë duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

## SHËNIME SHPJEGUESE

Shoqëria "CHERY ALBANIA" shpk. është regjistruar në

formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me një kapital themeltar prej 100,000 lekë të cilat zotërohen 50% nga ortaku i shoqërisë Z.Sokol Abdalli dhe 50% ortaku Spiro Gjoka.

### **I. POLITIKA KONTABËL**

Njësia ekonomike për hartimin e pasqyrave financiare për periudhën 01/01/2018 -

31/12/2018 është mbështetur në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të Shqipërisë.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, është sipas natyrës dhe është hartuar sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Pasqyra e fluksit të parasë është paraqitur me metodën direkte.

Mjetet monetare në arkë dhe bankë janë raportuar me vlerën e drejtë.

Kërkesa të tjera të arkëtueshme afatshkurtra janë paraqitur me vlerën e tyre neto të realizueshme.

Aktivitet afatgjatë materiale janë paraqitur me vlerën e kontabël të mbetur.

Detyrimet tatimore afatshkurtra janë paraqitur me vlerën e tyre neto të realizueshme.

Kapitali aksioner është paraqitur me vlerën kontabël të kuotave të kapitalit.

Pasqyrat financiare krahasuese të vitit 2018 janë përgatitur sipas kërkesave ekzistuese të kontabilitetit.



## II. SHËNIMET QË SHPJEGOJNË ZËRAT E PASQYRAVE KRYESORE.

### A - Bilanci kontabël, Aktivet

#### I. Aktivet Afatshkurtra

##### 1. Aktivet monetare

Banka në fund të periudhës tatimore paraqitet në shumën 0 lekë.

Depozitat në monedha të huaja janë konvertuar me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë më datë 31.12.2018, 1€ = 123.42 lekë dhe 1\$ = 107.82 lekë. Diferencat nga konvertimi janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### II. Aktivet Afatgjata

Aktivt Afatgjata materiale paraqiten me vlerën e tyre neto në shumën lekë.

Vlera kontabël e aktiveve afatgjata materiale në 31.12.2018 paraqitet si me poshtë:  
Mobilje zyre, pajisje informatike, mjete transporti 779,144 lekë.

### B - Bilanci kontabël, Pasivet

#### I. Pasivet afatshkurtra

1. Derivatitvet shoqëria nuk ka.
2. Huamarrjet afatshkurtra nuk ka.

#### 3. Huat dhe parapagimet.

Të pagueshme ndaj furnitorëve 440,060 lekë

Detyrime ndaj punonjësve 0 lekë

Detyrime tatimore për shumën

Sigurime Shoqërore ..... 0 lekë

TVSH 0 lekë

Tatim Fitimi 0 leke

TAP .....0 lekë

Tatim ne burim ..... 0 leke

### III. Kapitali

Kapitali aksioner ..... 100,000 lekë

Humbja e vitit financiar .....240,823 lekë.

### C. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve



### 1. Shitjet neto

Shitjet neto me vlerë prej lekë përbëhen nga të ardhurat e realizuara nga shitjet e mallrave dhe shërbimeve të ndryshme.

2. Kosto e punës me vlerë 0 lekë e ndarë si më poshtë:

- a) Pagat e punonjësve në shumën ..... 0 lekë
- b) Sigurimet shoqërore në shumën ..... 0 lekë

3. Shpenzimet të tjera me vlerë 240,823 lekë

Në këtë zë të bilancit janë pasqyruar të gjitha shpenzimet e tjera që janë kryer gjatë periudhës të vitit 2018, si shërbime nga nënkontraktorët, trajtime të përgjithshme, taksa dhe tarifa vendore.

ADMINISTRATOR I SHOQËRISË

(Sokol Abdalli)

